

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	EUSACombat Tirana 2026, ministri Gonxhja: 100% e sportistëve janë akomoduar në kushte optimale
ADRESA	https://kohajone.com/politike/eusacombat-tirana-2026-ministri-gonxhja-100-e-sportisteve-jane-akomoduar-ne-kushte-optimale/
BURIMI	kohajone.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 16:06:23 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 16:01:05 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2c5878493dfe415e222ef4757e84af2a022699d650a6052785b93d43a2907446
TEKSTI	1f002766c530e361f782e704c45a7a66ef4d156b07d8a83aa5e53edcfc4a21bd
PAMJA	dfda048ee50cdf02995f382e15344f2c3ca9813476b1b21102e6ebfb33b350fe

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b8323faec0d89bd12b37f9df3d14c4081c0b8c32758ef488dceb1f6a084078a8
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b8dae6c54853da1d85da2cfc2b078041a9e4d965e832e711de05f684850346bc
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b8323faec0d89bd12b37f9df3d14c4081c0b8c32758ef488dceb1f6a084078a8>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px


EUSACombat Tirana 2026, ministri Gonxhja: 100% e sportistëve janë akomoduar në kushte optimale

LAJME POLITIKE E DIEL, 13 SHTATOR 2026 18:01



Ministri i Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Blendi Gonxhja, ka reaguar pas disa postimeve të publikuara në rrjetet sociale lidhur me kushtet e akomodimit të sportistëve që po marrin pjesë në kampionatin EUSACombat – Tirana 2026.

Në reagimin e tij, Gonxhja hedh poshtë pretendimet për kushte të papërshtatshme akomodimi, duke argumentuar se pamjet e publikuara online nuk u përkasin ambienteve ku janë sistemuar delegacionet e huaja.



Sipas ministrit, kampionati zhvillohet në Tiranë nga 7 deri më 17 shtator 2026, me mbi 1,600 sportistë dhe shoqërues universitarë, nga rreth 400 universitete të 38 vendeve evropiane, në disiplinat taekwondo, karate, xhudo dhe kickboxing.



Gonxhja sqaron se aktiviteti organizohet nga Federata Shqiptare e Sportit Universitar, ndërsa Bashkia e Tiranës kishte dhënë garanci për akomodimin e rreth 1,500 pjesëmarrësve.

LAJMET KRYESORE



Opinion nga Elvin BLAKAJ:
"Jam mysliman" të Ben BLUSHIT e kam lexuar katër herë



Radio "Europa e Lirë": Si po përdoret IA-ja për sigurinë në shkollat e Shqipërisë



I rikthehet sërish pagave të gjyqtarëve, Rama: Marrin 280% më shumë se administrata, gati 2 mijë euro mbi pagën e Presidentit



Gjergj Luca inauguron "Rozafa Fier", një investim i ri pranë Apolonisë



Edhe një tentim për konstituim të parlamentit të Kosovës, PDK-ja s'merr pjesë

TË PËRZGJEDHURA



Edmond Spaho te Nikoll Lesi: PD ka mbaruar, nuk vjen ne pushtet!



Luka Modric konfirmon pjesëmarrjen me Kroacinë në Ligën e Kombeve



Dëshirat e Spallettit dhe blerjet e Juventus-it



Tesla, drejtimi gjysmë-autonom drejt përshtatjes me rregullat evropiane, thotë Franca



Shpërthen Erion Braçe te Nikoll Lesi në KOHA JONË-DEBAT: Nuk votoj kandidat me "njoftim"!

MË TË LEXUARAT

Reagimi i plote:

"Në lidhje me disa postime online mbi kushtet e akomodimit, në kuadrin e EUSACombat – Tirana 2026, sqarojmë se pretendimet e ngritura nuk pasqyrojnë situatën reale dhe krijojnë një panoramë të shtrembëruar.

Kampionati zhvillohet në Tiranë nga 7 deri më 17 shtator 2026, me pjesëmarrjen e mbi 1,600 sportistëve dhe shoqëruesve universitarë nga rreth 400 universitete të 38 vendeve europiane, në disiplinat taekwondo, karate, xhudo dhe kickboxing.

Aktiviteti organizohet tërësisht nga Federata Shqiptare e Sportit Universitar, e cila ka kërkuar një mbështetje financiare nga MTKS, që iu ofrua në shkurt 2026.

Sipas informacionit të përcjellë nga federata organizatore, Bashkia Tiranë kishte marrë përsipër dhe kishte lëshuar garanci për akomodimin e rreth 1,500 pjesëmarrësve. Kjo garanci, ka qenë pjesë e kushteve mbi të cilat EUSA miratoi zhvillimin e kampionatit në Shqipëri.

Vetëm pak ditë përpara fillimit të aktivitetit, organizatorët janë njoftuar se kapacitetet e parashikuara fillimisht nuk mund të vireshin plotësisht në dispozicion, pasi një pjesë e dhomave ishin të zëna nga studentë shqiptarë me kontrata njëvjeçare. Për të mos cenuar strehimin e tyre dhe për të garantuar vazhdimësinë normale të aktivitetit, një pjesë e delegacioneve është sistemuar në Kampusin Universitar të Institutit Bujqësor, Kamëz, në ambiente të vlerësuara si më të përshtatshme. 100% e miqve janë akomoduar në kushte optimale siç edhe shikohet qartazi në këtë video.

Pavarësisht se Ministria nuk ka asnjë përgjegjësi direkte organizative apo logjistike, zëvendësministri përgjegjës për sportin ka qenë personalisht i pranishëm në momentet e mbërritjes dhe pritjes së delegacioneve, duke shprehur gatishmërinë e plotë institucionale për të ndihmuar në adresimin e çdo nevojë që mund të paraqitej.

Duhet kuptuar se aktivitete të këtyre përmasave, kudo në Europë, nuk mbështeten në standardet e hoteleve superiore. Për akomodimin e mijëra sportistëve të rinj përdoren zakonisht kampuse universitare, rezidenca studentore, hostele rinore dhe njësi ekonomike akomodimi, duke garantuar kushtet e nevojshme të sigurisë, higjienës dhe funksionalitetit, edhe në funksion praktikiteti.

Imazhet e publikuara në rrjetet sociale, nuk u përkasin hapësirave ku janë sistemuar pjesëmarrësit e kampionatit. Nga verifikimet e kryera rezultojnë se ato mund t'u përkasin godinave të tjera të vjetra, të pabanuara e në pritje të rikonstruksionit. Paraqitja e këtyre pamjeve si ambiente ku qëndrojnë delegacionet e huaja është, për rrjedhojë, e pavërtetë dhe keqinformuese.

Në një aktivitet me mbi 1,600 pjesëmarrës, ku intervalet e zhvendosjeve e pauzave janë minimale, të pastrosh e të mirëmbash dhoma e ambiente sanitare kërkon turne e kapacitete të shtuara. Njëkohësisht, kërkohet bashkëpunim dhe respektim i rregullave edhe nga vetë përdoruesit, veçanërisht për mbetjet dhe sjelljen brenda dhomave dhe hapësirave të përbashkëta. Situata të veçuara nuk mund të paraqiten si prova të mungesës së angazhimit në të gjithë strukturën akomoduese.

Asnjë ushqim apo shërbim jashtë standardeve nuk është konstatuar nga strukturat përgjegjëse. Shërbimi i ushqimit dhe çdo element tjetër organizativ kontrollohen vazhdimisht nga organizatorët dhe ekipi ndërkombëtar i aktivitetit. Çdo mangësi apo parregullsi e evidentuar komunikohet drejtpërdrejt dhe trajtohet në kohë reale.

Përfaqësuesit e EUSA-s kanë inspektuar nga afër edhe ambientet e akomodimit, duke u njohur drejtpërdrejt me kushtet reale.

Organizatorët po punojnë për mbarëvajtjen e kampionatit, ndërsa Ministria, brenda rolit të saj ligjor dhe institucional, mbetet e gatshme për të kontribuar në adresimin e çdo nevojë që mund të kërkojë masa e zë.

Çdo problem konkret duhet të trajtohet me përgjegjësi, por nuk mund të pranohet që raste të izoluara, fotografi të paverifikuara apo ambiente që nuk përdoren nga delegacionet të shërbejnë për të cenuar një aktivitet madhor ndërkombëtar dhe imazhin e Shqipërisë si vend mikpritës", shkruan ministri.

MË SHUMË NGA LAJME






Kryeministri Rama mbërrin në Berat në turin e takimeve për të diskutu...



Egla Ceno rrëfen përplasjen me Ramën në takimin për Reformën Territor...



Premtimi i Trumpit për 5,000 dollarë 'dividend' shkakton ...



Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Skënder Hita: Shkolla ...



Votohet Qeveria "Kurti 4", Albin Kurti merr mandatin e ri si kryemini...



Nufi: Industria e mbrojtjes prioritet strategjik, gjashtë sipërmarrje...

LAJMET E FUNDIT



EUSACombat Tirana 2026, ministri Gonxha: 100% e sportistëve janë akomoduar në kushte optimale

[17 SEKONDA MË PARË](#)

"Pader Gjergj Fishta që ngjet hallkut bishta" – E për njato që keni para, mos ju lutni Zotit hiç

[7 MINUTA MË PARË](#)

Antonelli triumfon në Spanjë, zhgënjën sërish Hamilton

[15 MINUTA MË PARË](#)



Kryeministri Rama mbërrin në Berat në turin e takimeve për të diskutuar për reformën territoriale

[22 MINUTA MË PARË](#)



Egla Ceno rrëfen përplasjen me Ramën në takimin për Reformën Territoriale: "Na u tha se do të dëgjoheshim, por mbledh..."

[34 MINUTA MË PARË](#)

JUVENTUS – Juve, në Reggio Emilia me objektivin për të rregulluar shënjestrën: vetëm tre skuadra në Serinë A sh...

[39 MINUTA MË PARË](#)

MË SHUMË LAJME TË FUNDIT >

Gazeta "KOHA JONË" themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991

Botues: Nikoll LESI. Adresa e redaksisë: Rruga "Samë Frasheri", Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA

TË FUNDIT

LAJME

SPORTI

EKONOMI

EDITORIAL

WEBTV

RAJONI

KOSOVA

BOTA

TEKNOLOGJI

SHOWBIZ

SHËNDETI

SOCIALE

TURIZËM

KURIOZITETE

KULTURA

HISTORIKU

KONTAKT

BOTUES & DREJTOR: Nikoll LESI

KRYEREDAKTOR: Daniel MUÇAKU

ZV/KRYEREDAKTOR: Redjon SHTYLLA

BORDI: Elsa KAMBERI, KRYETARE

NIPT: J71425013C



NDËRTUAR DHE MIRËNBAHET NGA



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.